

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent

8 Prill, 2022

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Javën tjetër janë Pushimet Pranverore. Shkollat do të jenë të mbyllura gjatë gjithë javës, dhe shkollat dhe zyrat administrative do të mbyllën të Premten, më 15 Prill, në shenjë të së Premtes së Madhe.

Ne ju inkurajojmë që ta kaloni këtë kohë për t'u qetësuar dhe shplohur, por ju lutemi ta bëni këtë në mënyrë të sigurt. Rastet e COVID-19 po rriten në Filadelfia dhe ne të gjithë duhet të jemi tepër vigjilentë për të mbajtur veten dhe të tjerët rreth nesh të sigurt. Këtu janë disa mënyra se si mund të punojmë së bashku për të minimizuar rrezikun e një rritjeje në shkollat tona kur mësimet rifillojnë të Hënën, më 18 Prill

Maska **megjithëse** nuk është e detyrueshme, ju lutemi merrni parasysh të mbani atë për të mbuluar hundën dhe gojën kur jeni në ambiente të mbyllura publike, ku ka rrezik të lartë të transmetimit të COVID-19, si ngjarje të mbushura me njerëz ose tubime të mëdha. **Javën pas Pushimeve Pranverore, 18-22 Prill, të gjithë studentët dhe personeli do të duhet të mbajnë maska gjatë ditës së shkollës dhe të punës.** Drejtoria Arsimore në konsultim me Departamentin e Shëndetit Publik të Filadelfisë do të përcaktojë më pas nëse kushtet e COVID-19 mbështesin kthimin e sigurt në maskimin opsional.

Testohuni, **është falas** - po u kërkojmë të gjithë studentëve dhe personelit të testohen përpara se të ktheheni nga Pushimet Pranverore për t'u siguruar që jeni pa COVID-19, veçanërisht nëse keni simptoma të COVID-19 ose keni pasur kontakt të ngushtë me dikë që ka COVID-19. Për të ndihmuar, ne do t'i mbajmë të hapura pesë zonat tona të testimit javën e ardhshme të Hënën deri të Enjten nga ora 9 am deri në orën 18:00pm:

- Shkolla e Mesme Martin Luther King, 6100 Stenton Ave.
- South Philadelphia High School, 2101 S Broad Street (në parkingun në këndi i Jackson dhe S Broad)
- Samuel Fels High School, 5500 Langdon St.
- Overbrook High School, 5898 Lancaster Ave.
- Thomas Edison High School, 151 West Luzerne

Këto shkolla do të jenë të mbyllura të Premten e Mire, por do të kenë orarin e tyre normal për pjesën tjetër të vitit shkollor.

(Albanian)

✓ **Vaksinat dhe Boosters** /vaksina përforcuese - nuk është tepër vonë për të marrë vaksinën ose vaksinën përforcuese nëse nuk e keni bërë ende. Ju mund të gjeni vendndodhje pranë jush në faqen e internetit të qytetit të Filadelfias [këtu](#) ose në [www.vaccines.gov](http://www.vaccines.gov) duke klikuar tek "Find a Vaccine Clinic Near You" dhe duke futur kodin tuaj postar.

✓ **Qëndroni në shtëpi** - për mirëqenien e të gjithëve, ju lutemi qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë ose nëse rezultoni pozitiv dhe raportoni çdo rast pozitiv të "COVID Response Team" në [koronavirusreport@philasd.org](mailto:koronavirusreport@philasd.org).

✓ **Testimi për Personelin e Pavaksinuar** - testimi javor mbetet i detyrueshëm në këtë kohë.

Nëse Chromebook i fëmijës tuaj ka nevojë për riparim, Qendrat tona të Mbështetjes së Teknologjisë së Prindërve dhe Familjes do të jenë të hapura gjatë orëve normale të funksionimit javën e ardhshme, nga e Hëna deri të enjten, 11-14 Prill dhe të mbyllura të Premten. Më shumë informacion rreth qendrave tona të mbështetjes teknike dhe linjave telefonike mund të gjenden në [philasd.org/chromebooks](http://philasd.org/chromebooks).

Ky vit shkollor ka qenë një vit i vështirë për shumë nga familjet tona, të cilat vazhdojnë të përjetojnë nga afër pasojat e shumta tragjike të kësaj pandemie, dhunën e shfrenuar me armë, papunësinë dhe shumë trauma të tjera. Nëse keni nevojë për ndihmë, ofrohen shërbime këshillimi falas duke telefonuar Philly Hopeline në 1-833-PHL-HOPE (1-833-745-4673) ose duke dërguar mesazhe në të njëjtin numër. Nëse keni nevojë për vakte ushqimore gjatë kohës që shkollat janë të mbyllura javën e ardhshme, mund të gjeni informacione në zonat "Parks & Recreation" që do të ofrojnë ushqim falas për fëmijët deri në moshën 18 vjeç duke vizituar [phila.gov/food](http://phila.gov/food).

Ju urojmë Pushime Pranverore të qeta dhe të sigurta.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias